

Në bazë të nenit 17 alineja _____, të Statutit të BDI-së, Kongresi i BDI-së mbajtur më 19.12.2009 solli:

RREGULLORE PËR PUNËN E KONGRESIT TË DYTË TË BDI-SË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1

Me këtë Rregullore rregullohet organizimi, funksionimi, marrja e vendimeve dhe mënyra e zgjedhjes.

NENI 2

Kongresi punon në seanca plenare, sipas rendit të ditës i cili miratohet nga Kongresi

NENI 3

Kongresin e hap dhe me të udhëheq Kryetari i Partisë, deri në zgjedhjen e kryesisë së punës, të cilën ai e propozon.

Kongresi do të punojë në seanca plenare (Pjesa solemne dhe pjesa punuese).

SEANCA E PARË:

Pjesa solemne:

- Fjalimi i Kryetarit të Partisë dhe përshëndetjet nga miq të ftuar në Kongres.
- PJESA PUNUESE E KONGRESIT

Neni 4

Kryesia e punës e propozon rendin e ditës për punën e Kongresit, të cilën ai e miraton.

Propozime për plotësim apo ndryshimin e rendit të ditës mund të paraqet çdo delegat, por nëse e ka mbështetjen e më së paku 1/3 të delegatëve.

Kryesia e punës angazhohet që delegatët në seancat e Kongresit, të respektojnë rendin e ditës të miratuar.

Neni 5

Kongresi punon dhe sjell vendime të plotfuqishme, nëse në seancë marrin pjesë shumica e delegatëve që e përbëjnë Kongresin.

Votimi për sjelljen e vendimeve është i hapur dhe bëhet me ngritjen e dorës, nëse kongresi nuk vendos ndryshe.

KOMISIONET E KONGRESIT

Neni 6

Kongresi me propozim të kryesisë së punës zgjedh këto komisione punuese:

1. Komisioni për verifikimin e autorizimeve të delegatëve dhe numërin e tyre të pranishëm në Kongres; (3 anëtarë)
2. Komisioni kandidues; (5-anëtarë)
3. Komisioni zgjedhor; (7 anëtarë dhe 60 ndihmës për numërimin e votave, të cilët komisioni do t'i organizojë për punë)
4. Komisioni për interpretimin e Statutit dhe Rregullores për punën e kongresit; (3 -anëtarë)

RRJEDHA E PUNËS SË MËTEJSHME

Neni 7

Të drejtën për diskutim lidhur me pikën e rendit të ditës në seancat plenare, e ka çdo delegat në kohëzgjatje prej 5 minutave, edhe atë, vetëm njëherë dhe nëse kërkohet ndryshim dhe plotësim i materialit në fjalë, kjo të bëhet me shkrim.

Delegatët që dëshirojnë të diskutojnë në seancën e kongresit, duhet të paraqiten në 10 minutat e para, pas hapjes së debatit nga kryesia e punës.

Neni 8

Diskutuesi është i obliguar t'i përmbahet pikës së rendit të ditës, e cila është duke u shqyrtuar dhe të respektojë kohën për diskutim.

Nëse diskutuesi nuk u përmbahet këtyre rregullave, kryesia e punës ia merr fjalën.

Neni 9

Gjatë mbajtjes së kongresit, mbahet procesverbal dhe puna e kongresit mund të incizohet me pajisje teknike.

ZGJEDHJA E ORGANEVE

Neni 10

Propozimin e listës së kandidatëve për funksionet e organeve partiake drejtuar Kongresit, e bën Komisioni Kandidues.

Për 1/3 e kandidatëve të mundshëm për Këshillin e Përgjithshëm të Partisë, propozimi bëhet nga Kryetari i Partisë.

Propozim për plotësim apo ndryshim të listës së kandidatëve, për funksionet e organeve partiake mund të paraqes çdo delegat me mbështetjen e më së paku 1/3 të delegatëve, por atë propozim duhet ta miratojë Kongresi me shumicë të votave, nga delegatët e pranishëm në Kongres.

Neni 11

Pas verifikimit të listave të kandidatëve për votim nga Kongresi, Komisioni Zgjedhor i përgatit fletëvotimet, shpërgon mënyrën e votimit, shpërndanë fletëvotimet dhe organizon votimin.

Pas përfundimit të votimit, numëron votat dhe shpall rezultatet e votimit.

Nëse kandidatët për numrin e fundit të listës, e cila votohet, kanë numër të njëjtë të votave, atëherë Komisioni Zgjedhor organizon zgjedhjen e kandidatit/es përmes tërheqjes së shortit nga kandidatët me numër të njëjtë të votave.

MARRJA E VENDIMEVE DHE VOTIMI

Neni 12

Kongresi të gjitha vendimet i merr me shumicë të votave, nga të pranishmit në Kongres dhe komisionet punuese.

Zgjedhja e organeve në Kongres bëhet me vota të fshehta.

Neni 13

Për Kryetar të Partisë konsiderohet i zgjedhur kandidati i cili fiton mbi 50 për qind të votave, nga numri i përgjithshëm i delegatëve të Kongresit.

Në rrethin e dytë, fiton kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të delegatëve që kanë votuar, me kusht që të kenë votuar mbi 50 për qind të delegatëve, dhe numri i votave që ka fituar kandidati të mos jetë më i vogël se 1/3 e numrit të përgjithshëm të delegatëve të Kongresit.

Neni 14

Anëtar i zgjedhur i Këshillit të Përgjithshëm, konsiderohet kandidati që fiton shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i delegatëve të Kongresit.

Nëse kandidati pas votimit nuk e fiton shumicën e duhur, atëherë votimi përsëritet për aq kandidatë sa kanë ngelur për t'u zgjedhur.

Në rrethin e dytë dhe në rrethet në vazhdim, fiton kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të delegatëve që kanë votuar, me kusht që të kenë votuar mbi 50 për qind të delegatëve të pranishëm.

Nëse deri në numrin 75 ka më tepër kandidatë me numër të njëjtë të votave, atëherë kandidatët të zgjedhur do të konsiderohen kandidatët që përcaktohen nëpërmjet shortit që e realizon Komisioni Zgjedhor.

ANKIMIMI

Neni 15

Kandidati që eventualisht ka vërejtje në procesin e numërimit të votave, mundet që në afat prej 24 orë nga momenti i kumtimit të rezultateve të ankohet me shkrim deri

te Komisioni Zgjedhor. Të drejtë ankese ka kandidati i cili ka fituar deri më 10 vota më pak se kandidati me numër rendor 75, në listën e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Komisioni Zgjedhor në afat prej 48 orë, nga momenti i shpalljes së rezultateve në Kongresin e II do të organizoj rinumërimin e votave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm. Gjatë procesit të rinumërimit të votave, duhet të jenë të pranishëm shumica e anëtarëve të Komisionit Zgjedhor, kandidati që ka bërë ankesë dhe aq kandidat prej listës së Këshillit të Përgjithshëm të zgjedhur në Kongresin e II të partisë, duke numëruar nga fundi sa ankesa janë bërë nga kandidatët për anëtar të Këshillit të Përgjithshëm.

Kandidati që ka bërë ankesë për procesin e numërimit të votave, mundet të merr pjesë vetëm në rinumërimin e votave për vete.

Vendimin e Komisionit Zgjedhor lidhur me ankesat, Kryetari i komisionit me gjithë materialet ia dorëzon Kryetarit të Partisë për zbatim.

MËNYRA E VOTIMIT

Neni 16

Komisioni Zgjedhor para se votuesit-delegatit t'ia jep fletëvotimin, kërkon nga ai autorizimin përkatës të tij për votim.

Neni 17

Votimi bëhet me një fletëvotim për zgjedhjen e kryetarit dhe e njëjta vlen edhe për zgjedhje të Këshillit të Përgjithshëm.

Fletëvotimit, para se t'i jepet votuesit (delegatit me të drejtë vote) i vendohet vula e Kongresit.

Votuesi-Delegati me të drejtë vote, votimin e bën në atë mënyrë, që rrethon numrin rendor para emrit dhe mbiemrit të kandidatit (rrethon vetëm një numër të kandidatëve për kryetar të partisë), ndërsa në fletëvotimin për kandidatët për Këshillin e Përgjithshëm, rrethon 75 numra para emrit dhe mbiemrit të kandidatëve, ndërsa ata që nuk i voton i shlyen me të njëjtën ngjyrë. Në të kundërtën fletëvotimi do të jetë i pa vlefshëm.

Votimi bëhet pas paravanëve votues dhe fletëvotimi palohet dhe hidhet në kutinë e votimit.

SUMIMI DHE KUMTIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT

Neni 18

- Së pari numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe shënohet numri i tyre në procesverbal.
- hapet kutia e votimit dhe fillohet me numërimin e votave.
- për secilën kuti votuese, caktohet nga një përgjegjës

nga grupi i komisionit zgjedhor.

- Komisioni Zgjedhor vërteton se, a është fletëvotimi i vlefshëm ose jo dhe për cilin kandidat është votuar
- Fletëvotimet e vlefshme dhe të pavlefshme ndahen në grupe dhe vazhdohet me numërimin e votave tjera në mënyrë të njëjtë.

FLETËVOTIMET E VLEFSHME

Neni 19

Fletëvotimi është i vlefshëm, nëse është në përputhshmëri me nenin 17 të kësaj Rregulloreje.

Fletëvotimi është i pavlefshme, nëse nuk është i plotësuar ose ka rrethuar më tepër ose nuk i ka shlyer ata që nuk i voton.

PROCESVERBALI NGA VOTIMI

Neni 20

Komisioni zgjedhor, në procesverbalin për votim shënon këto të dhëna:

- numrin e përgjithshëm të delegatëve me të drejtë vote, numrin e përgjithshëm që kanë votuar, numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të hedhura në kutitë e votimit, numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve që nuk janë përdorur dhe numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefshme.
- numrin e përgjithshëm të votave që ka fituar çdo kandidat.
- procesverbalin e nënshkruan kryetari dhe anëtarët e Komisionit Zgjedhor dhe i njëjti është i vlefshëm nëse nënshkruhet nga anëtarët shumicë të Komisionit Zgjedhor.
- për rezultatet e votimit, komisioni i raporton Kongresit.
- pas përfundimit të votimit, materiali votues dhe procesverbali ruhet në arkivin e partisë.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Gjatë punës së Kongresit, nëse paraqiten raste që nuk janë të rregulluara me normat e kësaj Rregulloreje, do të praktikohen normat e Statutit.

Neni 22

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga Kongresi.

KONGRESI II

Shkup, 19 dhjetor 2009

RREGULLORE



Bashkimi
Demokratik për Integrim
www.bdi.org.mk